



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT

6866/6
Nr. _____ Prot.

Tiranë, më 28.10.2025

URDHËR

Nr. 555, datë 28.10.2025

PËR

MIRATIMIN E PROGRAMEVE MËSIMORE TË DISA LËNDËVE TË
KURRIKULËS BËRTHAMË, TË DISA KLASAVE TË ARSIMIT BAZË

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të shkronjës “ç”, të pikës 2, të nenit 45 të ligjit nr. 69/2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të shkronjave “dh” dhe “e”, të pikës 5, të kreut III, të vendimit nr. 98, datë 27.02.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për krijimin, mënyrën e organizimit e të funksionimit të Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar” dhe të urdhrit nr. 497, datë 29.09.2025 “Për delegimin e kompetencave dhe caktimin e detyrave të zëvendësministrit të Arsimit znj. Orjana Osmani”, i ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Miratimin e “Programit mësimor të përditësuar, të lëndës “Gjuhë angleze”, të kurrikulës bërthamë, për klasën e parë të arsimit fillor”, sipas shtojcës 1, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij urdhri.
2. Miratimin e “Programit mësimor të lëndës “Qytetari”, të kurrikulës bërthamë, për klasën e parë të arsimit fillor”, sipas shtojcës 2, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij urdhri.
3. Miratimin e “Programit mësimor të përditësuar, të lëndës “Matematikë”, të kurrikulës bërthamë, për klasën e parë të arsimit fillor”, sipas shtojcës 3, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij urdhri.
4. Miratimin e “Programit mësimor të përditësuar, të lëndës “Dituri natyre”, të kurrikulës bërthamë, për klasën e parë të arsimit fillor”, sipas shtojcës 4, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij urdhri.
5. Miratimin e “Programit mësimor të përditësuar, të lëndës “Edukim fizik, sport dhe shëndet”, të kurrikulës bërthamë, për klasën e parë të arsimit fillor”, sipas shtojcës 5, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij urdhri.

6. Miratimin e "Programit mësimor të përditësuar, të lëndës "Muzikë", të kurrikulës bërthamë, për klasën e parë të arsimit fillor", sipas shtojcës 6, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij urdhri.
7. Miratimin e "Programit mësimor të përditësuar, të lëndës "Art pamor", të kurrikulës bërthamë, për klasën e parë të arsimit fillor", sipas shtojcës 7, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij urdhri.
8. Miratimin e "Programit mësimor të përditësuar, të lëndës "Teatër", të kurrikulës bërthamë, për klasën e pestë, klasën e gjashtë dhe klasën e shtatë të arsimit bazë", sipas shtojcës 8, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij urdhri.
9. Miratimin e "Programit mësimor të përditësuar, të lëndës "Gjuhë shqipe", të kurrikulës bërthamë, për klasën e gjashtë të arsimit të mesëm të ulët", sipas shtojcës 9, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij urdhri.
10. Miratimin e "Programit mësimor të përditësuar, të lëndës "Gjuhë angleze", të kurrikulës bërthamë, për klasën e gjashtë të arsimit të mesëm të ulët", sipas shtojcës 10, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij urdhri.
11. Miratimin e "Programit mësimor të lëndës "Qytetari", të kurrikulës bërthamë, për klasën e gjashtë të arsimit të mesëm të ulët", sipas shtojcës 11, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij urdhri.
12. Miratimin e "Programit mësimor të përditësuar, të lëndës "Histori", të kurrikulës bërthamë, për klasën e gjashtë të arsimit të mesëm të ulët", sipas shtojcës 12, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij urdhri.
13. Miratimin e "Programit mësimor të përditësuar, të lëndës "Gjeografi", të kurrikulës bërthamë, për klasën e gjashtë të arsimit të mesëm të ulët", sipas shtojcës 13, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij urdhri.
14. Miratimin e "Programit mësimor të përditësuar, të lëndës "Matematikë", të kurrikulës bërthamë, për klasën e gjashtë të arsimit të mesëm të ulët", sipas shtojcës 14, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij urdhri.
15. Miratimin e "Programit mësimor të përditësuar, të lëndës "Fizikë", të kurrikulës bërthamë, për klasën e gjashtë të arsimit të mesëm të ulët", sipas shtojcës 15, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij urdhri.
16. Miratimin e "Programit mësimor të përditësuar, të lëndës "Biologji", të kurrikulës bërthamë, për klasën e gjashtë të arsimit të mesëm të ulët", sipas shtojcës 16, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij urdhri.
17. Miratimin e "Programit mësimor të përditësuar, të lëndës "Edukim fizik, sport dhe shëndet", të kurrikulës bërthamë, për klasën e gjashtë të arsimit të mesëm të ulët", sipas shtojcës 17, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij urdhri.
18. Miratimin e "Programit mësimor të përditësuar, të lëndës "Gjuhë e huaj e dytë (frënge, italiane, gjermane), për shkollat me marrëveshje me ambasadat", të kurrikulës bërthamë, për klasën e gjashtë të arsimit të mesëm të ulët", sipas shtojcës 18, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij urdhri.
19. Miratimin e "Programit mësimor të përditësuar, të lëndës "Gjuhë e huaj e dytë", të kurrikulës bërthamë, për klasën e gjashtë dhe klasën e shtatë të arsimit të mesëm të ulët", sipas shtojcës 19, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij urdhri.

20. Miratimin e “Programit mësimor të përditësuar, të lëndës “Muzikë”, të kurrikulës bërthamë, për klasën e gjashtë të arsimit të mesëm të ulët”, sipas shtojcës 20, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij urdhri.
21. Miratimin e “Programit mësimor të përditësuar, të lëndës “Art pamor”, të kurrikulës bërthamë, për klasën e gjashtë të arsimit të mesëm të ulët”, sipas shtojcës 21, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij urdhri.
22. Programet mësimore të klasës së parë dhe klasës së gjashtë hyjnë në fuqi dhe fillojnë zbatimin në vitin shkollor 2026 – 2027.
23. Programet mësimore të klasës së shtatë hyjnë në fuqi dhe fillojnë zbatimin në vitin shkollor 2027 – 2028.
24. Programi mësimor i klasës së pestë hyn në fuqi dhe fillon zbatimin në vitin shkollor 2029 – 2030.
25. Programet mësimore të mëparshme, shfuqizohen sipas fillimit të zbatimit të programeve mësimore të lëndëve në klasat e sipërcituara.
26. Ngarkohen për zbatimin e këtij urdhri, Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit të Arsimit Parauniversitar, Agjencia Kombëtare e Arsimit Parauniversitar, Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar, drejtoritë rajonale të arsimit parauniversitar, zyrat vendore të arsimit parauniversitar dhe institucionet arsimore parauniversitare.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

ZËVENDËSMINISTRI

ORJANA OSMANI



PROGRAMI I LËNDËS “TEATËR” ARSIMI FILLOR DHE I MESËM I ULËT KLASAT 5-6-7

FUSHA “ARTET”

PROGRAM I PËRDITËSUAR

Koordinator: Marina Topulli



PËRMBAJTJA

1	HYRJE.....	5
2	QËLLIMI DHE OBJEKTIVAT E PËRGJITHSHME TË LËNDËS	6
2.1	QËLLIMI	6
2.2	Objektivat e përgjithshme të lëndës	7
3	PËRMBAJTJA E PROGRAMIT.....	8
4	KOMPETENCAT DHE AFTËSITË QË ZHVILLON LËNDA E TEATRIT	11
4.1	Kompetencat kyçe dhe rezultatet e të nxënit	11
4.2	Temat ndërkurrikulare dhe lidhja me lëndën e teatrit	17
4.3	Kompetencat e lëndës së teatrit dhe rezultatet e të nxënit	18
5	PËRMBAJTJA MËSIMORE DHE REZULTATET E TË NXËNIT	22
5.1	Koha mësimore për secilën tematikë për klasën e pestë, gjashtë dhe shtatë.	22
5.2	Përmbajtja e lëndës sipas tematikave dhe përshkrimi i përmbledhur i tyre.....	22
5.3	Shembuj të veprimtarive për përmbushjen e rezultateve të të nxënit (RN-ve).....	39
6	METODOLOGJIA E MËSIMDHËNIES	43

6.1	Qëllimi dhe roli i situatave të të nxënit praktike nga jeta reale në mësimin e teatrit.	43
7	VLERËSIMI I NXËNËSVE	45
7.1	Shembuj të niveleve të arritjes për vlerësimin e rezultateve të të nxënit, RN-ve.	45
8	BURIMET DHE MATERIALET DIDAKTIKE	48
8.1	Burimet Didaktike për Mësimin e Teatrit	48
8.2	Përdorimi i Teknologjisë në Mësimin e Teatrit.....	49
9	REKOMANDIME PËR ZBATIMIN E PROGRAMIT	51

Përmbajtja e tabelave

Tabela 1. Kompetencat kyç dhe rezultatet e të nxënit për klasat 5-7.....	15
Tabela 2: Kompetencat artistike dhe rezultatet e të nxënit	20
Tabela 3: Orë të sugjeruara për çdo tematikë.....	22
Tabela 4. Shembull i veprimtarive për përmbushjen e RN-ve.....	40
Tabela 5. Shembull 1 dhe 2 për nivelet e arritjes për vlerësimin e RN-ve.....	46

Përmbajtja e diagrameve

Diagrama 1 Përmbajtja e programi lëndor të teatrit.....	9
Diagrama 2. Korniza konceptuale e lëndës së teatrit: Tematika, Kompetenca lëndore dhe Kompetencat kyç	19
Diagrama 3. Shembull situatë të nxëni dhe lidhja me elementet e programit “Një objekt, një botë”	42

1 HYRJE

Teatri është një nga artet më të vjetra në botë dhe njohja e teatrit mbart një vlerë të madhe në zhvillimin e personalitetit të nxënësve, të aftësisë së tyre për të punuar në grup, për të konsideruar mënyrën si e sheh botën tjetri, për të folur në mënyrë të denjë në publik dhe për të zhvilluar prirjet e tyre artistike, krijuese e kritike.

Një nxënës që e njeh teatrin di ta vlerësojë dhe do ta vlerësojë atë edhe në të ardhmen, ai është në gjendje të marrë mesazhet e dhura dhe emocione të plota kur ndjek një shfaqje, madje një takim që në vogëli me teatrin ndez në individë të caktuar edhe dëshirën për t'u marrë me teatër, në një kohë kur kjo prirje nuk nxitet në asnjë formë tek të rinjtë, përveçse nga familja.

Veprimtaritë e ndryshme dramaturgjike e çojnë nxënësin të interpretojë me shije materiale të ndryshme artistike, të përdorë aftësitë e tij fizike e krijuese për të përcjellë mesazhe, për të krijuar karaktere dhe realitete artistike që ngrihen në një shkallë më lart se realiteti.

Teatri, duke qenë specifik, kërkon disa dije bazë për ta kuptuar dhe shijuar, pra është një lëndë që nuk mund të ofrohet që në fazat e para të fëmijërisë. Në moshën 11-13 vjeçare, kur fëmija po del nga loja, po hyn në adoleshencë dhe po krijon personalitetin e tij në shoqëri, ai po kalon faza që ngjasojnë shumë me një rol skenik, ku fëmija përpiqet të ruajë tiparet e tij, por edhe të përshtatet me ambientin që e rrethon. Kjo është moshë kur fëmija fillon të krijojë qëndrimet e tij ndaj botës dhe filozofive në botë, ndaj dhe teatri është mjeti më i mirë që i tregon lidhjen mes lojës fëmijore e ritualit primitiv, drejt një arti e mardhënieje më të ndërlikuar siç është tetari dhe mundësia krijuese që të jep ai duke përdorur gjithë kapacitetin njerëzor të fjalës, trupit dhe gjinive të ndryshme krijuese. Nëpërmjet këtyre orëve fëmija mëson edhe konceptet bazë si *përqendrimi, artikulimi i fjalëve, fuqia bindëse e tyre (oratoria dhe të folurit publik), besimi në lojë si aktor, hapësira skenike artistike, fuqia artistike për të përcjellë mesazhe dhe për shpalosur atë që kemi brenda vetes, konvencioni artistik.*

- Duke e përjetuar teatrin nga vetë skena, ai do të fillojë të vlerësojë edhe më mirë këtë lloj gjinie, *kënaqësinë* që marrim prej teatrit dhe do të ketë një gjykim kritik ndaj punëve skenike, që do të shohë në të ardhmen.

2 QËLLIMI DHE OBJEKTIVAT E PËRGJITHSHME TË LËNDËS

2.1 QËLLIMI

Qëllimi i teatrit në arsimin fillor dhe të mesëm të ulët është shumë i rëndësishëm për zhvillimin e kulturës artistike të nxënësve. Kjo lëndë ka si qëllim të ndihmojë nxënësit të zhvillojnë aftësitë e tyre komunikuese, emocionale dhe krijuese përmes lojës dramatike, ndërtimit të personazhit dhe situatave të improvizuara.

Përmes lojës artistike nxënësit do të jenë në gjendje:

- Të kuptojnë elementët bazë të dramës: personazhi, dialogu, veprimi.
- Të zhvillojnë vetëbesimin dhe komunikimin në grup.
- Të mësojnë të shprehin emocione dhe ide përmes trupit dhe zërit.
- Të interpretojnë skena të thjeshta në mënyrë kreative.

Qëllimet e lëndës së teatrit për klasat 5- 7:

Q 1: Të ndihmojë nxënësit të zhvillojnë aftësitë e tyre komunikuese, emocionale dhe krijuese përmes lojës dramatike, ndërtimit të personazhit dhe situatave të improvizuara.

Q 2: Të zhvillojë më tej të kuptuarit e nxënësve për ndërtimin dramatik, marrëdhëniet mes personazheve dhe përdorimin e mjeteve teatrale për të komunikuar mesazhe artistike.

Q3: Të aftësojë nxënësit në krijimin, analizimin dhe interpretimin e skenave më të ndërlikuara dramatike, si dhe të thellojë të kuptuarit për teatrin si formë arti dhe komunikimi.

2.2 Objektivat e përgjithshme të lëndës

Objektivat e përgjithshme që synohen të arrihen në përfundim të klasës së shtatë kërkon që nxënësit:


- Të kuptojnë elementët bazë të dramës: personazhi, dialogu, veprimi.
- Të zhvillojnë vetëbesimin dhe komunikimin në grup.
- Të mësojnë të shprehin emocione dhe ide përmes trupit dhe zërit.
- Të interpretojnë skena të thjeshta në mënyrë kreative.
- Të analizojnë struktura të thjeshta dramatike.
- Të ndërtojnë dhe interpretojnë personazhe me emocione komplekse.
- Të punojnë në grup për të krijuar skena me rrjedhë logjike.
- Të përdorin mjete të thjeshta skenike dhe tinguj për efekt dramatik.
- Të krijojnë skenarë të shkurtër dhe të ndajnë rolet në mënyrë të pavarur.
- Të përdorin elementët e skenografisë dhe kostumeve në mënyrë funksionale.
- Të analizojnë marrëdhëniet ndërpersonale përmes dramës.
- Të interpretojnë një shfaqje të plotë në fund të ciklit mësimor.

3 PËRMBAJTJA E PROGRAMIT

Programi i teatrit synon të krijojë kushte të favorshme për ndërtimin dhe zhvillimin e kompetencave të lëndës dhe të kompetencave kyçe, duke u mbështetur në situata të jetës reale dhe në kontekstin shkollor. Në thelb, ky program përqendrohet në edukimin dhe formimin kulturor të nxënësve si individë të aftë për të kuptuar, zbatuar dhe interpretuar njohuritë dramaturgjike në mënyrë sa më të drejtë dhe të bukur në jetën e tyre të përditshme. Programi i lëndës së teatrit në arsimin e mesëm të ulët përmban:

- a) *Kompetencat kyçe dhe rezultatet e të nxënësve që zhvillohen nëpërmjet lëndës së teatrit.* Lënda e teatrit kontribuon drejtpërdrejt në ndërtimin e kompetencave kyçe si dhe aftësive të shekullit 21-të si: të menduarin kritik dhe zgjidhjen e problemeve, aftësitë qytetare, aftësitë digjitale etj. *Temat ndërkurrikulare dhe zhvillimi i tyre nëpërmjet lëndës së teatrit.* Programi i teatrit ndërthur njohuritë dhe aftësitë e saj me temat ndërkurrikulare si: identiteti kombëtar dhe njohja e kulturave; qytetaria aktive dhe sipërmarrja; shëndeti mendor e fizik dhe siguria; zhvillimi i qëndrueshëm dhe qëndrueshmëria mjedisore; teknologjia, shoqëria dhe media duke i lidhur konceptet dramaturgjike me situata konkrete që nxënësit përballen në jetën e tyre.
- b) *Kompetencat e lëndës së teatrit dhe rezultatet e të nxënësve.* Lënda e teatrit synon të pajisë nxënësit me kompetenca sepse teatri nuk është vetëm një disiplinë artistike, por një mjet i fuqishëm për të zhvilluar aftësi kyçe të shekullit 21. Ai e përgatit nxënësin për të qenë *krijues, bashkëpunues, komunikues efektiv dhe qytetar aktiv* në një botë në zhvillim të vazhdueshëm. Aftësitë kyçe të shekullit 21, janë një grup kompetencash që i ndihmojnë individët të jenë të suksesshëm në një botë që ndryshon me shpejtësi, të drejtuar nga teknologjia, informacioni dhe globalizimi. Lënda e teatrit, në mënyrë të natyrshme, kontribuon fuqishëm në zhvillimin e këtyre aftësive.

Diagrama 1 Përmbajtja e programi lëndor të teatrit



- c) *Përmbajtja mësimore dhe rezultatet e të nxënit.* Në këtë rubrikë përshkruhet koha e dedikuar (numri i orëve mësimore) të klasës së pestë, gjathtë dhe shtatë për çdo tematikë, duke ofruar hapësirë për punë individuale, në grup etj; tematikat e lëndës dhe përshkrimi i përmbledhur i tyre; njohuritë kryesore, aftësitë për secilën tematikë dhe qëndrimet që demonstroi nxënësi.
- d) *Metodologjia e mësimdhënies.* Në lëndën e teatrit është e rëndësishme t'i kushtohet një vëmendje e madhe përdorimit të metodave artistike që kanë lidhje të drejtpërdrejtë me lojën artistike, teknikave dhe proceseve artistike, bashkëpunimit etj. Përshtatja e mësimi për nxënës me nevojë të veçanta dhe mbështetja e talenteve në lëndën e teatrit nxit kuriozitetin për lëndën. Në këtë rubrikë do të ketë edhe disa shembuj veprimtarish për përmbushjen e rezultateve të të nxënit.
- e) *Vlerësimi i nxënësve është një tjetër rubrikë,* e cila përshkruan në mënyrë të përmbledhur llojet e vlerësimit të nxënësit, shembuj të instrumenteve të vlerësimit dhe të vetvlerësimit, vlerësimin si metodologji të nxëni. Gjithashtu në këtë rubrikë do të ketë edhe shembuj të niveleve të arritjes së rezultateve të të nxënit.
- f) *Burimet dhe materialet didaktike* që mund të përdoren në lëndën e teatrit. Njohja me konceptet e artit dramatik, teknikat dhe proceset artistike dhe vepra të ndryshme dramaturgjike në periudhat më të rëndësishme që ka kaluar arti dramatik të sjellë nga burime të ndryshme dhe materiale didaktike të demonstruara me mjete konkrete.
- g) *Rekomandime për zbatimin e programit.* Në këtë rubrikë do të ketë disa rekomandime për përdoruesit e programit lëndor sic janë: nxënësit, mësuesit, vlerësuesit e jashtëm të cilësisë, prindërit.
- h) *Ndryshimet përmbajtësore.* Në këtë rubrikë do të përshkruhen përditësimet kryesore në përmbajtjen lëndore.

4 KOMPETENCAT DHE AFTËSITË QË ZHVILLON LËNDA E TEATRIT

4.1 Kompetencat kyçe dhe rezultatet e të nxënit

Zhvillimi i kompetencave kyçe nga nxënësit gjatë procesit të mësimdhënies dhe të nxënies kërkon që mësuesi të sigurojë një lidhje të qëndrueshme dhe funksionale midis kompetencave kyç dhe atyre të lëndës, sipas klasave të arsimit fillor dhe arsimit të mesëm të ulët. Kjo kërkon një planifikim të kujdesshëm të situatave të të nxënit, si dhe përzgjedhjen e metodave, mjeteve dhe burimeve të përshtatshme që nxisin angazhimin, reflektimin dhe zbatimin praktik të njohurive. Teatri nuk është vetëm një disiplinë artistike, ai është një mjet i fuqishëm për të zhvilluar aftësi të ndryshme komunikuese, bashkëvepruese, dhe jo vetëm artistike, por edhe jetësore dhe humane. Ai e përgatit nxënësin, të njohë vlerat dhe të përmirsojë difektet e veta, për të qenë *krijues, bashkëpunues, komunikues efektiv dhe qytetar aktiv* në një botë në zhvillim të vazhdueshëm.

a) Kompetenca Komunikuese

Aftësitë që zhvillohen:

- Njohja me hapsirën në të cilën komunikon arti teatral, në prani të publikut. (teatri si institucion i ndarë përmes skenës ku zhvillohet veprimi skenik dhe publikut)
- Përdorimi efektiv i gjuhës së folur, duke zgjeruar fjalorin e gjuhës shqipe.
- Artikulim me elokuencë dhe llogjikë i mendimit, për një qëllim të caktuar.
- Të rrisë Fantazinë dhe Imagjinatën për të krijuar, jo për të qenë një riprodhues mekanik.
- Komunikimi joverbal (gjestet, mimika, gjuha e trupit).
- Aftësia për tu përqëndruar tek shqisat, (të parit, të dëgjuarit, të nuhaturit, të prekurit) për të perceptuar në mënyrë të drejtë dhe reaguar në mënyrë të përshtatshme, duke zhvilluar dhe perfeksionuar “Harkun Reflektor” individual.

Si zhvillohet në teatër për këtë grupmoshë: Përmes dialogëve, monologëve, lojës me zë, interpretimit të emocioneve dhe situatave.

b) Kompetenca Sociale dhe Qytetare

Aftësitë që zhvillohen:

- Bashkëpunimi në grup.
- Respektimi i roleve dhe përgjegjësi.
- Empatia dhe ndjeshmëria ndaj të tjerëve.
- Aftësia për të reflektuar mbi ndjenjat e veta dhe të të tjerëve.

Si zhvillohet në teatër për këtë grupmoshë: Në punë grupi, role të ndërlidhura, interpretim emocionesh dhe trajtim temash sociale.

c) Kompetenca Kulture dhe Artistike

Aftësitë që zhvillohen:

- Të kuptuarit dhe vlerësimi i artit dramatik.
- Zhvillimi i ndjenjës estetike dhe shprehjes artistike.
- Aftësia për të interpretuar vepra artistike.
- Krijimi i veprave të vogla dramatike (skena, personazhe, dialogë).

Si zhvillohet në teatër për këtë grupmoshë: Përmes leximit, interpretimit dhe krijimit të veprave të vogla artistike dhe njohjes së historisë së teatrit.

d) Kompetenca e të Nxënit

Aftësitë që zhvillohen:

- Reflektimi mbi përvojën dhe mësimin.
- Vlerësimi i përparimit personal.
- Pranimi i komenteve konstruktive.
- Zhvillimi i vetëbesimit në përfaqësim publik.

Si zhvillohet në teatër për këtë grupmoshë: Me ushtrime reflektive pas çdo aktiviteti, vlerësim vetjak dhe punë në grup.

e) Kompetenca Digjitale

Aftësitë që zhvillohen:

- Përdorimi i mjeteve për regjistrim, prezantim apo montim.
- Prezantimi i një pjese dramatike në video apo platformë online.
- Kërkim i informacionit rreth historisë së teatrit apo veprave.

Si zhvillohet në teatër për këtë grupmoshë: Në projekte ndërdisiplinore, prezantime digjitale, filmime ose përdorim i mjeteve vizuale.

Aftësi të përgjithshme që mbështeten përtej kompetencave

Aftësi	Si zhvillohet përmes teatrit
Kreativitet dhe imagjinatë	Në krijimin e personazheve dhe skenave.
Mendim kritik dhe analitik	Në analizën e konflikteve dramatike dhe zgjidhjeve që ofrojnë personazhet.
Aftësi për zgjidhjen e problemeve	Në ndërtimin e skenarëve dhe reagimin ndaj situatave të improvizuara.
Vetëbesim dhe vetëprezantim	Në daljen përpara të tjerëve dhe interpretimin e roleve.

Kompetenca kuptohet sot si një ndërthurje e balancuar mes njohurive, aftësive, qëndrimeve, vlerave dhe mendimit kritik, që mundësojnë nxënësin të përballet me situata reale dhe komplekse në mënyrë efektive dhe të pavarur. Qasja e mësimdhënies e bazuar në kompetenca e zhvendos fokusin nga përvetësimi pasiv i përmbajtjes lëndore (me mësuesin si qendër të procesit) drejt formimit të aftësive që ndihmojnë nxënësin të kuptojë, të zbatojë dhe të transferojë njohuritë në situata të reja dhe jetësore, duke u vendosur vetë nxënësi në qendër të procesit. Rezultatet e të nxënit për kompetencat kyç që duhet të zhvillojë nxënësi në të trija klasat 5-6-7- në lëndën e teatrit mund të përmbledhen si më poshtë:

Tabela 1. Kompetencat kyç dhe rezultatet e të nxënësve për klasat 5-7.

Kompetenca e komunikimit në gjuhën amtare	Kompetenca e komunikimit në gjuhë të huaja
<i>Për të dëshmuar kompetencën e komunikimit në gjuhën amtare, nxënësi:</i> - Përdor gjuhën e folur në mënyrë të qartë dhe shprehëse në skenë. - Formulon dhe interpreton dialogë dhe monologë. - Kupton dhe përdor fjalor specifik të artit dramatik (personazh, skenë, konflikt, etj.).	<i>Për të dëshmuar kompetencën e komunikimit në gjuhë të huaj, nxënësi:</i> - Përdor shprehje të thjeshta në një gjuhë të huaj gjatë interpretimeve ose përshëndetjeve. - Kupton dhe interpreton fragmente të thjeshta të dramave klasike në gjuhë të huaj (opsional).
Kompetenca në STEM (matematikë, shkencë, teknologji dhe inxhinieri)	Kompetenca digjitale
<i>Për të dëshmuar kompetencat në STEM, shkencë, teknologji dhe inxhinieri, nxënësi:</i> - Zbaton nocione hapësinore dhe kohore në lëvizjen në skenë. - Respekton strukturën logjike të një skene (hyrje–nyje lidhëse–pikë kulmore– zgjidhje-fund).	<i>Për të dëshmuar kompetencën digjitale, nxënësi:</i> - Përdor mjete digjitale për të regjistruar ose paraqitur një skenë. - Kërkon informacione për autorë, periudha dramatike dhe interpretime.

- Kupton dhe përdor orarin dhe kohën në planifikimin e një shfaqjeje.	- Përdor aplikacione për krijimin e materialeve vizuale të dramës.
Kompetenca personale, shoqërore dhe e të nxënit	Kompetenca qytetare
<i>Për të dëshmuar kompetencën personale, shoqërore dhe të nxënies, nxënësi:</i>	<i>Për të dëshmuar kompetencën qytetare, nxënësi:</i>
- Reflekton mbi përvojën e vet në skenë përmes diskutimit dhe shkrimit. - Vlerëson përparimin personal në interpretim. - Pranon kritikën dhe sugjerimet për përmirësim.	- Punon në mënyrë bashkëpunuese dhe me përgjegjësi në grup. - Respekton mendimet dhe idetë e të tjerëve në skenë. - Trajton tema sociale dhe qytetare përmes skenave dramatike.
Kompetenca e sipërmarrjes	Kompetenca për vetëdijen dhe shprehjen kulturore
<i>Për të dëshmuar kompetencën e sipërmarrjes, nxënësi:</i>	<i>Për të dëshmuar kompetencën për vetëdijen dhe shprehjen kulturore, nxënësi:</i>
- Merr iniciativë në krijimin e skenave, roleve dhe projekteve. - Organizohen në role për të realizuar një shfaqje. - Zgjidh probleme që lindin gjatë përgatitjes së një performance.	- Njihet me vepra të huaja dhe vendase dhe i respekton vlerat që ato përcjellin. - Reflekton mbi ngjarje dhe konflikte kulturore përmes roleve. - Promovon përfshirjen dhe barazinë në punën në grup.

4.2 Temat ndërkurrikulare dhe lidhja me lëndën e teatrit¹

Integrimi i temave ndërkurrikulare me teatrin në arsimin fillor dhe atë të mesëm të ulët u mundëson nxënësve të kuptojnë më thellë lidhjet ndërmjet teatrit dhe jetës reale, duke i ndihmuar ata të zhvillojnë aftësi analitike, mendim kritik, argumentim dhe zgjidhje problemesh. Këto tema përforcojnë përdorimin e teatrit si mjet për interpretimin e të dhënave, planifikimin, marrjen e vendimeve dhe vlerësimin e situatave të ndryshme shoqërore, kulturore dhe shkencore.

Edukimi për të drejtat e njeriut dhe qytetarinë aktive: Teatri trajton shpesh padrejtësi, barazi, zëdhënie për të marginalizuarit. *Psh:* skena mbi bullizmin, barazinë gjinore, drejtësinë në një komunitet.

Edukimi mjedisor: Përmes roleve dhe situatave dramatike, nxënësit përjetojnë ndikimin e ndotjes, humbjes së natyrës, etj. *Psh:* skena me dialog mes natyrës dhe njeriut, ose një dramë për mbrojtjen e një pylli.

Edukim për paqen dhe zgjidhjen e konflikteve: Teatri lejon të eksplorosh konflikte dhe mënyra për t'i zgjidhur përmes empatisë, psh: improvizim mbi një konflikt në shkollë që përfundon me pajtim.

Barazia gjinore: Roli i vajzave dhe djemve në skenë trajtohet në mënyrë të barabartë. Përdoren role të shkëmbyeshme që theksojnë se aftësia nuk varet nga gjinia. *Psh:* një skenë ku një vajzë merr rol udhëheqës; dramë mbi sfidat e një vajze që kërkon të ndjekë pasionin.

¹ Veprimtaritë praktike të zhvillimit të temave ndërkurrikulare mund të përshkruhen në udhëzuesit kurrikularë lëndorë - teatri.

Ndërkulturalizmi dhe diversiteti kulturor: Teatri prezanton personazhe dhe realitete nga kultura të ndryshme. Inkurajon tolerancën dhe njohjen e tjetrit. *Psh:* përkthim dhe interpretim i përrallave ndërkombëtare; skena mbi mikpritjen.

Shëndeti mendor dhe mirëqenia: Dramaturgjia ndihmon nxënësit të shprehin emocionet dhe të kuptojnë ndjesitë e të tjerëve. *Psh:* ushtrime për shprehjen e ndjenjave përmes gjuhës trupore; dramë mbi vetëbesimin.

Edukim digjital dhe i mediave: Përdorimi i mediave në dramë (videoprojekttime, regjistrim i skenave) dhe edukimi për përmbajtjen mediatike. Realizimi i një video-skeçi dramatik që trajton varësinë nga rrjetet sociale.


Edukimi për sipërmarrje: Nxënësit planifikojnë, ndajnë role, drejtojnë projekte dramatike – një formë e sipërmarrjes kreative. Organizimi i një mini-shfaqjeje ku secili nxënës ka një përgjegjësi (regjisor, aktor, skenograf).

Edukimi për trashëgiminë kulturore dhe historinë: Përmes veprave shqiptare dhe ndërkombëtare, nxënësit lidhen me historinë, zakonet dhe identitetin kombëtar. *Psh:* interpretim i një legjende shqiptare; dramatizimi i një ngjarjeje historike.

4.3 Kompetencat e lëndës së teatrit dhe rezultatet e të nxënit

Bazuar në këtë kurrikul, lënda e teatrit synon të përmbushë 3 kompetenca, të cilat lidhen me kompetencat kyçe që një nxënës duhet të zotërojë gjatë jetës së tij dhe që arrihen nëpërmjet 3 tematikave kryesore. Këto kompetenca zbërthehen në rezultate të nxëni për secilën klasë.

Diagrama 2. Korniza konceptuale e lëndës së teatrit: Tematika, Kompetenca lëndore dhe Kompetencat kyç



Gjithashtu lënda e teatrit, zhvillon një sërë aftësish ku nxënësit angazhohen në aktivitetet dramaturgjike dhe zhvillojnë kompetencat artistike.

Tre janë kompetencat këndore të teatrit që përftohen nga njohuritë dhe përfshijnë:

Tabela 2: Kompetencat artistike dhe rezultatet e të nxënit

KOMPETENCAT LËNDORE - TEATËR		
Kompetencat lëndore	Përshkrimi i kompetencave	Rezultatet e të nxënit për kompetencat për klasën e pestë/gjashtë/shtatë
Krijimi skenik	- Nxënësi: nëpërmjet kompetencës së krijimit, nxënësi zhvillon aftësinë për të imagjinuar dhe ndërtuar situata dramatike, personazhe dhe dialogë origjinalë. Ai angazhohet në procesin e zhvillimit të një ideje që vjen nga përvoja personale, ngjarje reale apo burime letrare dhe e kthen atë në formë skenike. Krijimi nuk kufizohet vetëm në shkrimin e tekstit dramatik, por përfshin gjithashtu edhe konceptimin e skenografisë, kostumeve dhe atmosferës skenike që mbështet mesazhin artistik.	Nxënësi: - Përdor mjete të ndryshme krijuese për të zhvilluar një ide dramatike. - Harton skena dhe personazhe me koherencë dhe thellësi. - Shfaq origjinalitet dhe imagjinatë në përpunimin e temave artistike. - Bashkëpunon me të tjerët në krijimin e një vepre teatrale.

Interpretimi skenik	- Nxënësi: nëpërmjet performimit, nxënësi mëson të japë jetë një personazhi dhe të komunikojë me publikun nëpërmjet gjuhës trupore, zërit, emocioneve dhe pranishmërisë skenike. Ai kupton rëndësinë e bashkëpunimit në skenë, të disiplinës dhe të praktikës, si dhe zhvillon vetëbesimin dhe vetëkontrollin. Gjatë performimit, nxënësi lidh emocionin me teknikën, për të sjellë një përvojë autentike për shikuesin.	Nxënësi: - Interpreton role të ndryshme duke përdorur mjete të ndryshme shprehëse (zë, lëvizje, mimikë). - Kupton dhe respekton rregullat e punës në skenë dhe të disiplinës teatrale. - Merr pjesë aktive në prova dhe shfaqje me përgjegjësi dhe përkushtim. - Zhvillon vetëbesimin dhe aftësinë për të komunikuar publikisht.
Vlerësimi i veprave dramaturgjike	- Nxënësi: nëpërmjet kompetencës së vlerësimit përfshin aftësinë për të reflektuar mbi procesin krijues dhe performues, si dhe për të analizuar vepra teatrale të tjera. Nxënësi mëson të japë dhe të marrë feedback konstruktiv, të kuptojë elementet që përbëjnë një vepër skenike dhe të vlerësojë ndikimin që ajo ka tek publiku. Ai zhvillon mendimin kritik dhe ndjeshmërinë estetike, duke nxjerrë mësim nga çdo përvojë teatrale.	- Nxënësi: - Analizon elementet bazë të një performance teatrale (personazhet, temat, mjetet skenike). - Jep vlerësime të argumentuara mbi vepra teatrale të shfaqura ose të krijuara nga vetë ai dhe grupi. - Reflekton mbi rolin e tij në grup dhe mbi përparimin personal në teatrin shkollor. - Zhvillon vlerësim për artin si mjet komunikimi dhe ndikimi shoqëror.

5 PËRMBAJTJA MËSIMORE DHE REZULTATET E TË NXËNIT

5.1 Koha mësimore për secilën tematikë për klasën e pestë, gjashtë dhe shtatë.

Lënda e teatrit zhvillohet për 35 javë mësimore me nga 0.5 orë secila, pra gjithsej 18 orë për secilën klasë. Lënda e teatrit specifikon kohën (orët e sugjeruara) e secilës tematikë për klasën e pestë, gjashtë dhe shtatë. Shuma e orëve sugjeruese për secilën tematikë është e barabartë me sasinë e orëve vjetore, të përcaktuar në planin mësimor të arsimit bazë. Kjo ka si qëllim që, përdoruesit e programit të orientohen për peshën që zë secila tematikë në orët totale vjetore.

Tabela 3: Orë të sugjeruara për çdo tematikë

Tematika	Gjuha dhe komunikimi	Teknika dhe procese	Historia, teatri dhe shoqëria	Gjithsej orë
Klasa e pestë	6	6	6	18 orë
Klasa e gjashtë	6	6	6	18 orë
Klasa e shtatë	6	6	6	18 orë

5.2 Përmbajtja e lëndës sipas tematikave dhe përshkrimi i përmbledhur i tyre

Programi i lëndës “Teatër” zhvillohet përmes tri tematikave: *Tematika I: Gjuha dhe komunikimi*, *Tematika II: Teknika dhe procese*, *Tematika III:*

Historia, teatri dhe shoqëria.

Për secilën tematikë janë paraqitur njohuritë, aftësitë, që duhet të demonstrojë nxënësi lidhur me tematikat përkatëse, ndërkohë qëndrimet dhe vlerat që demonstroi nxënësi në lëndë e teatrit përmbledhen për të gjitha tematikat. Tematikat dhe renditja e tyre **nuk** presupozojnë që përmbajtja vjetore, përgjatë vitit shkollor, duhet të zhvillohet e ndarë sipas tematikave dhe në këtë renditje. Sasia e orëve mësimore për secilën tematikë është rekomanduese. Përdoruesit e programit duhet të respektojnë sasinë e orëve vjetore të lëndës, kurse janë të lirë të ndryshojnë me 10% (shtesë ose pakësim) orët e rekomanduara për secilën tematikë.

TEMATIKA: GJUHA DHE KOMUNIKIMI

Përshkrimi i tematikës

Përmbajtja e kësaj tematike mundëson që nxënësi të njihet me njohuritë kryesore dhe zhvillojë aftësitë e komunikimit verbal dhe joverbal, duke përdorur zërin dhe trupin për të shprehur emocione; praktikojnë dialogun dhe bashkëpunimin në interpretim; zhvillojnë aftësi të avancuara komunikimi dhe interpretimi përmes monologut dhe dialogut dramatik. Në mësimet e teatrit për nxënësit e klasave 5 deri në 7, gjuha dhe komunikimi zënë një rol qendror, pasi ato janë baza për çdo shprehje dramatike. Nxënësit mësojnë të përdorin jo vetëm fjalët, por edhe gjuhën e trupit, mimikën, intonacionin dhe pauzat për të shprehur ndjenjat dhe për të komunikuar mesazhet në mënyrë efektive. Në fillim, në klasën e pestë, ata praktikojnë shprehjen e emocioneve bazë dhe dialogun të thjeshtë, ndërsa me kalimin e viteve mësojnë të ndërtojnë dialogje më komplekse që përfshijnë konflikte dhe zgjidhje, duke zhvilluar kështu aftësitë e tyre komunikuese në situata të ndryshme. Përmes lojërave dhe dramatizimeve, nxënësit fitojnë vetëbesim në të folur dhe të dëgjuarit, dhe mësojnë të bashkëpunojnë me të tjerët në mënyrë të respektueshme dhe kreative.

KLASA V

NJOHURITË	AFTËSITË
- Përdorimi i zërit - Shprehja e emocioneve bazë (gëzim, trishtim, frikë) me gjeeste, zë dhe mimikë. - Marrë-dhënia me objektet dhe njohja me hapsirën skenike - Njohja e rrethanës dramatike - Veprimi Dramatik - Personazhi	<i>Nxënësi demonstroi se:</i> - Frymëmarrja dhe sidomos frymënxjerrja, janë baza për të krijuar një zë të bukur jo vetëm në teatër, por edhe në jetën e përditshme. Përmirësimi i këtij elementi jetësor, ndihmon për të kaluar vështirësitë me fraza të gjata, duke mos humbur logjikën e interpretimit. <i>Ushtrime të frymëmarrjes dhe aparatit folës, nëpërmjet lojës, për përmirësimin e diksionit dhe të folurës së shpejtë dhe me rritëm të caktuar. Psh. Ardhja e një treni në stacion dhe largimi i tij prej andej, vetëm nëpërmjet zërit, lëvizjeve dhe gjeesteve.</i> - Aktori është bartësi kryesor i veprimit dramatik në teatër. Ai është vetë instrument dhe se pa të nuk ka teatër. - Teatri është një konvencion i jetës reale dhe si i tillë objektet dhe fjalët, nuk përdoren vetëm në kuptimin e tyre të parë. (fjalët kanë nën kuptime ose nën tekst, kurse objektet funksione të shumëfishta. Psh; <i>një tavolinë shërben për të ngrënë bukë por ajo mund të kthehet edhe në një varkë.</i>) - kupton elementët bazë të dramës: personazhi, dialogu, veprimi, vendi ku zhvillohet konflikti, kushtet dhe rrethanat. psh: vënia në skenë duke dramatizuar fabula, apo legjenda të ndryshme (të huaja dhe shqiptare) <i>Loja me role, ndërtimi i karakterit përmes veshjes apo aksesoreve duke krijuar të vërtetëndierin e saktë me moton: “Unë në këto rrethan dhe kushte, si do tëveproja.</i>

	- Improvizim me dy personazhe në konflikt (nxënës që zihen për një libër). Loja “Pasqyra” në çift, mimika dhe gjuhë trupore. - zhvillon vetëbesimin dhe komunikimin në grup. Psh: Krijimi i një historie me fillim, kulm dhe fund në grup. - mëson të shprehin emocione dhe ide përmes trupit dhe zërit. Psh: Tregim personal i dramatizuar nga grupi (shkova në park, humba rrugën...) - interpreton skena të thjeshta në mënyrë kreative. Psh: Loja “Ky vend është...” ku nxënësit luajnë në vende të ndryshme të imagjinuara. - shpreh me zë dhe mimikë emocione të ndryshme (gëzim, trishtim, frikë). - Luan dialoge të shkurtër në çift me komunikim të qartë. - Respekton rregullat e dëgjimit dhe foljes në lojën teatrale. Teknikat Artistike: • Mimikë dhe gestikulacion: Lojë “Ndrysho emocionin” ku ndryshohen shprehjet e fytyrës. • Dialog i improvizuar: Tema “Në kopshtin zoologjik” me role të ndryshme kafshësh. • Përdorimi i intonacionit: Ushtrime për ndryshimin e kuptimit me ndryshimin e zërit.
--	--

	Vepra/autorë: - Dramatizimi i përrallës “Luani dhe miu” - Përralla “Qengji dhe ujku” (pjesë dramatike të thjeshtuara) - Legjenda e Rozafës - Plaku dhe djemtë (Toka është flori) - Gjergj Elez Alia dhe Bajlozi i zi - “Nastradini” – karakter me tipare të theksuara - Tekste të thjeshta dialogësh nga “Gishtoja” - Shprehje emocionale pa fjalë me maska - Historia “Zhurma në bibliotekë” – komedi shkollore - Ambient klasor që kthehet në shtëpi, pyll, shkollë, etj.
KLASA VI	
NJOHURITË	AFTËSITË
- - Thellim i më tejshëm i punës me zërin. - Zhvillimi i personazhit - Dialogu dramatic me konflikte dhe zgjidhje - Intonacioni dhe pauza	<i>Nxënësi demonstroi se:</i> - interpreton tregime dhe poezi të ndryshme, duke përcjellë emocione të sakta, nëpërmjet intonacionit, ku çdo fjalë ka peshën e saj specifike emocionale. - Përdor pauzat emocionale, për të theksuar rëndësinë e situatës, duke i dhënë kuptimin logjik dialogut.

- Interpretimi i emocioneve të thelluara (xhelozia, frikë, gëzim) - Kostumet dhe objektet	- Zgjidh konfliktet përmes skenave dramatike. - analizon struktura të thjeshta dramatike. Psh: Ditari i personazhit”: nxënësit shkruajnë si personazhi i tyre. Loja “Dyshimi”: nxënësit luajnë një skenë ku njëri fsheh diçka - ndërton dhe interpreton personazhe me emocione komplekse. Psh: Leximi me zë dhe interpretim i intonacionit të ndryshëm - punon në grup për të krijuar skena me rrjedhë logjike. Psh: Krijimi i një skene mbi një temë sociale (miqësia, xhelozia, ndihma. - përdor mjete të thjeshta skenike dhe tinguj për efekt dramatik. Psh; Krijimi i efekteve zanore për skena të ndryshme (stuhi, natë, festa). - Përdorimi i një objekti për të ndryshuar personazhin. Teknikat Artistike: - Ushtrime me pauza dhe intonacion: Lexime dramatike me ndryshim të ritmit. - Dialogje me konflikt: Krijimi i skenave ku dy personazhe kanë qëndrime të ndryshme. - Simbolika në trup dhe zë: Përdorimi i lëvizjeve të vogla për shprehjen e emocioneve. - Vepra: - Pjesë nga drama “Toka Jonë” (për klasë, pjesë të thjeshtuara)
--	--

	- Sketch-e komike të shkruara nga nxënësit (p.sh., “Fshatari që donte të bëhej mbret”) - Fragment nga “Andra e Artës” – Fatmir Gjata - Konflikt shoqëror: fshehja e një sekreti në klasë - “Një shok i ri në klasë” – krijim kolektiv - Loja “Tingulli i historisë” – zhurmat bëhen nga nxënësit - Loja “Magjia e shallit” – një shall = personazh i ri
KLASA VII	
NJOHURITË	AFTËSITË
- - Analiza e karakterit - Monologu dhe rrëfimet personale - Ndërtimi i skenarit - Regjia e skenës -	<i>Nxënësi demonstroi se:</i> - interpreton monologje me nëntekst dhe emocione të thella. - Krijon dhe interpreton monologje me tema personale ose shoqërore. - Komunikon drejtpërdrejt me publikun me siguri. - Krijon skenarë të shkurtër dhe të ndajnë rolet në mënyrë të pavarur. Psh: Grupi krijon një tekst dramatik mbi një temë të caktuar. “Pyet personazhin”: nxënësit intervistojnë njëri-tjetrin në rol. Nxënësi shkruan një monolog dhe e interpreton para klasës. - përdor elementët e skenografisë dhe kostumeve në mënyrë funksionale. Psh: Përdorimi i hapësirës, ndriçimit dhe zërit për efekt dramatik.

	- analizon marrëdhëniet ndërpersonale përmes dramës. Psh; Drama për situata reale: bullizmi, dallimet sociale, etj - interpreton një shfaqje të plotë në fund të ciklit mësimor: psh: Përgatitja e një pjese për publikun e shkollës/prindërit. Teknikat Artistike: - Analiza e monologut: Ushtrime për të zbuluar nëntekstin dhe emocionet. - Teatër direkt: Kontakt me audiencën përmes monologut. - Dramaturgji personale: Shkrim dhe interpretim i monologjeve. Vepra: - Monologë origjinalë të nxënësve “Një moment që më ndryshoi” - Pjesë të adaptuara nga drama “Gjenerali i Ushtrisë së Vdekur” - Tema: “Një ditë pa telefona” – shoqëria sot. - Personazhe nga realiteti: mësuesi, prindi, shoku i lagjes. - Monolog personal: “Kur më refuzuan në ekip...”
TEMATIKA: TEKNIKA DHE PROCES	
<i>Përshkrimi i tematikës</i>	

Kjo tematikë fokusohet në zhvillimin e aftësive praktike dhe kreative që kërkon teatri: interpretimin e roleve, ndërtimin e skenave, përdorimin e trupit dhe zërit, si dhe teknikat e improvizimit dhe dramatizimit. Nxënësit eksplorojnë lëvizjen trupore, pozicionimin në skenë, përdorimin e kostumeve dhe rekuizitave, duke i dhënë jetë personazheve dhe situatave dramatike. Nëpërmjet ushtrimeve të ndryshme praktike, ata mësojnë të bashkëpunojnë, të ndajnë rolet dhe të punojnë në grupe për të krijuar skena dhe shfaqje. Procesi përfshin edhe përgatitjen e shfaqjeve të vogla, ku nxënësit praktikojnë koordinimin dhe disiplinën në interpretim dhe performancë. Ky rrugëtim i ndihmon ata të zhvillojnë imagjinatën, të ndjehen rehat në skenë dhe të kuptojnë rëndësinë e bashkëpunimit artistik.

KLASA V	
NJOHURITË	AFTËSITË
- Improvizimi dhe krijimi i situave - Ndërtimi i një skene dramatike (filli, pikë kulmore fund) - Bashkëpunimi dhe rolet në grup - Maskat - Gjestet	<i>Nxënësi demonstroi se:</i> - ndërton dhe interpreton një skenë të thjeshtë me fillim, pikë kulmore dhe fund. - Përdor lëvizje trupore për të shprehur situata dhe karaktere. - Bashkëpunon në grup për të improvizuar situata të ndryshme. - njeh rolin e maskave dhe gjeesteve në interpretim. - krijon personazhe përmes maskave dhe gjeesteve. - praktikon komunikimin pa fjalë. - krijon maska dhe interpretojnë emocione të ndryshme. Teknikat Artistike: - Struktura dramatike: Punë në grupe për ndërtimin e një mini-skene.

	- Lëvizje në hapësirë: Ushtrime për pozicionimin në skenë dhe përdorimin e trupit. - Lojë me maska; përdorim i trupit dhe gjesteve; mimikë. - Improvizim: Tema “Një keqkuptim mes miqsh” për zhvillimin e historisë. Vepra: - Skena origjinale të nxënësve bazuar në temat e përditshme. - Mini-pjesë nga përrallat e dramatizuara. - Sofokliu – fragmente dramatike.
KLASA VI	
NJOHURITË	AFTËSITË
- Analiza e personazhit - Lëvizja dhe pozicionimi në skenë - Improvizimi I udhëzhequr - Krijim personazhi	<i>Nxënësi demonstroi se:</i> - krijon personazhe me karakteristika të qarta. - ndërton scena me hyrje, konflikt dhe zgjidhje. - përdor pozicionimin në skenë për të forcuar mesazhin. - demonstroi lëvizje të qarta dhe di të pozicionohet në skenë. - ndërton mini-skenash ku përdoren kostume dhe rekvizita për të shprehur historinë.

	Teknikat Artistike: - Profilizimi i personazhit: Ushtrime për ndërtimin e historisë së personazhit. - Diagrami i skenës: Përgatitje e skenave me një strukturë të qartë. - Lëvizje dramatike: Ushtrime të koordinuara me hapësirën. Vepra: - Mini-pjesë dramatike origjinale “Një keqkuptim mes miqsh” - Pjesë komike dhe dramatike nga sketch-et e nxënësve - Dramat e Mesjetës (fragmente).
KLASA VII	
NJOHURITË	AFTËSITË
- Ndërtimi i shfaqjes së plotë: regjia, skenografia, kostumet, dritat - Organizimi i roleve në grup - Regjia dhe funksionet e grupit	<i>Nxënësi demonstroi se:</i> - merr pjesë në ndërtimin e një shfaqjeje të plotë në grup. - Zbaton rolet dhe detyrat e secilit në teatër. - Përdor elemente teknike për të përforcuar interpretimin. - praktikon teknika të avancuara si analiza teksti, improvizimi i udhëhequr dhe krijim personazhi. - analizon tekstin dhe të krijojnë personazhe me thellësi.

- improvizon skena dramatike.
- Analizë dhe interpretim fragmente nga veprat klasike;
- krijim versioni modern ose improvizim i skenave.

Teknikat Artistike:

- **Regjia bazë:** Udhëzime për drejtimin e skenës.
- **Kostumet dhe rekuizitat:** Përdorim i tyre për karakterizim.
- **Skenografia dhe ndriçimi:** Elemente bazë për krijimin e atmosferës.

Vepra:

- Shfaqje e plotë me tema sociale ose personale e punuar nga nxënësit
- Shakespeare, Molière (fragmente).

TEMATIKA: HISTORIA, TEATRI DHE SHOQËRIA

Përshkrimi i tematikës

Përmbajtja e kësaj tematike mundëson që nxënësi të kuptojnë lidhjen midis teatrit, historisë dhe shoqërisë. Veprimtaria e ndjekura: Lexim dhe interpretim fragmente nga drama historike, dramatizim i skenave nga periudha të ndryshme. Teknikat e përdorura: Aktrim në grupe, interpretim i teksteve klasike, improvizim historik. Në këtë tematikë, nxënësit njihen me origjinën dhe zhvillimin e teatrit. Ata mësojnë për rëndësinë e teatrit si pasqyrë e shoqërisë dhe si mjet për të shprehur ide, vlera dhe kritika sociale. Përmes njohjes së përrallave popullore, komedisë dhe skenave dramatike tradicionale, nxënësit kuptojnë se teatri nuk është vetëm argëtim, por edhe një mënyrë për të reflektuar mbi jetën dhe marrëdhëniet njerëzore. Duke dramatizuar këto vepra, ata zhvillojnë vetëdijen kulturore dhe sociale, dhe kuptojnë rëndësinë e bashkëpunimit dhe komunikimit në grup si në skenë ashtu edhe në jetë. Në këtë mënyrë, teatri bëhet një urë mes së kaluarës dhe të tashmes, dhe një hapësirë ku vlerat njerëzore dhe shoqërore mund të diskutohen dhe zhvillohen.

KLASA V

NJOHURITË	AFTËSITË
Periudha Historike : Teatri i Lashtë (Greqia e lashtë) - Vlera e mesazheve dhe përcjellja e tyre përmes teatrit - Roli i maskës në Greqinë e lashtë - Aktori dhe interpretimi	<i>Nxënësi demonstroi se:</i> - identifikon mesazhe morale në tregime dhe shfaqje. - ndërton shfaqje të thjeshta me bashkëpunim në grup. - kupton teatrin si mjet komunikimi dhe reflektimi shoqëror. - njeh rrënjët e teatrit në Greqinë e lashtë dhe rolin e tij në shoqëri. - kupton rolin e maskës dhe aktorit në teatër. - lidh teatrin me festat dhe ritualet.

	Teknikat Artistike: - Dramatizim i tregimeve popullore: Luajtje e roleve me përdorim të kostumeve të thjeshta. - Krijim dhe interpretim i maskave; lojë me emocionet sipas traditës së teatrit grek. - Diskutim reflektues: Pasi luan, nxënësi diskuton për mesazhin dhe vlerat. - Bashkëpunim në grup: Punë në grup për përgatitjen dhe shfaqjen e një skene. Vepra: - Përrallat “Luani dhe miu”, “Qengji dhe ujku” - Një skenë e thjeshtë popullore (p.sh., “Kreshniku dhe hajduti” – pjesë e përshtatur) - Vepra: Sofokliu – “Antigona” (fragmente të përshtatura).
KLASA VI	
NJOHURITË	AFTËSITË
- Periudha Historike: Teatri Romak dhe Mesjetar - Teatri dhe aktorët si pasqyrë e shoqërisë dhe mjet reflektimi social - Komedia dhe roli i saj në shoqëri	<i>Nxënësi demonstroi se:</i> - kupton dhe interpreton humorin dhe satirën në teatrore. - Luajt sketch-e me mesazhe sociale. - Respekton dhe vlerëson teatrin popullor.

- Përdorimi i gjesteve dhe kostumeve të ekzagjeruara - Teatri popullore shqiptar	- njeh teatrin romak dhe mesjetar, dhe lidhjen me jetën shoqërore. - kupton përdorimin e teatrit në sheshe dhe rrugë. - Dramatizon skena të shkurtëra shqiptare ose nga mesjeta në grupe. Teknikat Artistike: - Sketch i improvizuar: Përdorimi i humorit për të trajtuar çështje shoqërore. - Dramatizim me elemente popullore: Veshje dhe kostume të thjeshta. - Diskutim pas shfaqjes: Analizë e mesazheve dhe reflektim. Vepra: - Sketch-e të përzgjedhura nga folklori dhe sketch-e origjinale të nxënësve - Pjesë nga komeditë popullore shqiptare - Dramat e Mesjetës (fragmente).
KLASA VII	
NJOHURITË	AFTËSITË
- Periudha Historike: Shekulli i XVI–XVII, Rilindja - Teatri si mjet për ndryshim shoqëror dhe vetëdije	<i>Nxënësi demonstroi se:</i> - përdor teatër për të diskutuar dhe reflektuar mbi çështje shoqërore. - Merr pjesë në shfaqje interaktive me ndryshime në rol.

- Dialogu dhe personazhet komplekse,
- Ndjenja universale

- Kupton rëndësinë e artit në vetëdijen qytetare.
- njeh rolin e dramaturgëve të mëdhenj dhe ndikimin e teatrit në shoqëri në shekullin XVI–XVII.
- analizon ndikimin shoqëror dhe kulturor të dramës klasike.
- interpreton fragmente nga vepra të njohura.
- Lexon dhe diskuton fragmente nga Shakespeare;
- interpreton versione moderne të teatrit.

Teknikat Artistike:

- **Forum Teatri:** Ushtrime për ndërrimin e rolit dhe reagimin ndaj situatave.
- **Dramatizim interaktiv:** Pjesëmarrje aktive dhe ndryshim i ngjarjes.
- **Diskutim dhe reflektim:** Pas shfaqjes mbi temat e trajtuara.

Vepra:

- Skena “Një shok lihet jashtë” (tema bullizmi)
- Pjesë interaktive të krijuara nga nxënësit
- Ëilliam Shakespeare – “Romeo dhe Zhulieta”.

QËNDRIME DHE VLERA

Nxënësi:

- zhvillon vetëbesimin për të interpretuar para të tjerëve.
- shpreh dhe menaxhon emocionet përmes lojës dramatike.
- njeh dhe respekton emocionet e të tjerëve përmes përjetimit të roleve.
- zhvillon imagjinatën në ndërtimin e situatave dhe personazheve.
- reflekton mbi veten dhe përjetimet personale përmes teatrit.
- punon në mënyrë bashkëpunuese me të tjerët në ndarjen e roleve dhe detyrave.
- respekton rregullat e punës në grup dhe mendimet e të tjerëve.
- zhvillon ndjeshmëri ndaj diversitetit përmes roleve dhe situatave të ndryshme.
- tregon durim dhe mirëkuptim gjatë procesit të përgatitjes së një shfaqjeje.
- ndërton marrëdhënie pozitive përmes komunikimit artistik.
- shpreh qartë mendime dhe ndjenja nëpërmjet zërit, trupit dhe mimikës.
- përdor forma të ndryshme komunikimi verbal dhe joverbal në interpretim.
- dëgjon dhe ndërvepron në mënyrë aktive gjatë procesit dramatik.
- angazhohet në dialog me bashkëmoshatarët përmes situatave teatrale.
- përdor gjuhën artistike për të shprehur ide personale.
- kupton mesazhet shoqërore që përcillen përmes veprave dramatike.
- reflekton mbi vlerat njerëzore dhe situatat reale përmes roleve teatrale.
- njeh dhe vlerëson trashëgiminë kulturore shqiptare përmes pjesëve popullore.
- përdor teatrin si mjet për të shprehur ide ose qëndrime sociale.

- Nxënësi demonstroi ndjeshmëri ndaj sfidave dhe problemeve të komunitetit.
- tregon krijimtari në ndërtimin e personazheve dhe situatave.
- respekton procesin artistik nga ideja deri te shfaqja.
- analizon elemente estetike të një skene ose shfaqjeje.
- përpaket të përmirësohet përmes reflektimit dhe kritikës ndërtuese.
- merr përgjegjësi për rolin e tij në një projekt artistik në grup

5.3 Shembuj të veprimtarive për përmbushjen e rezultateve të të nxënit (RN-ve)².

Në këtë rubrikë paraqiten disa shembuj të veprimtarive që mund të përdoren nga mësuesi për përmbushjen e rezultateve të të nxënit në tematika të ndryshme.

² Në udhëzuesit kurrikularë për lëndën e teatrit do të përshkruhen veprimtari praktike për përmbushjen e rezultateve të të nxënit sipas tematikave të lëndës.


Tabela 4. Shembull i veprimtarive për përmbushjen e RN-ve

REZULTAT TË NXËNI TË ORËS MËSIMORE	VEPRIMTARIA PRAKTIKE
SHEMBULLI	
“Zbaton rolet dhe detyrat e secilit në teatër.”	<i>Prezantimi i situatës</i> Të ndihmojë nxënësit të kuptojnë rolet që ekzistojnë në një trupë teatrore (aktorë, regjisorë, ndihmës, skenografë, etj.) dhe të përjetojnë përmes një aktiviteti praktik se si funksionon një grup artistik në mënyrë të bashkërenduar dhe të përgjegjshme. Mësuesi përgatit një tekst i thjeshtë për t’u dramatizuar (mund të jetë përrallë, një sketch i shkurtër, apo një fragment nga një vepër e njohur). Pastaj prezanton një fletë me përshkrimin e roleve (aktor, regjisor, kujdestar kostumesh, kujdestar rekuizitash, asistent regjisor, drejtues skene, etj.) si dhe disa rekuizita të thjeshta dhe kostume simbolike (kapele, shallë, libra, kuti, etj.) Mësuesi nis me një bisedë të shkurtër: “Në një shfaqje teatri, a mendoni se vetëm aktorët janë të rëndësishëm? Po kush tjetër punon që një shfaqje të jetë e suksesshme?” Ai prezantohen rolet kryesore që ndodhen në një trupë teatrore dhe jep fletë të përshkruajnë çdo rol. Më pas mësuesi i ndan në grupe grupe 5–6 vetë dhe përcakton rolet ku çdo nxënës zgjedh një rol të caktuar në trupë (aktor, regjisor, kujdestar i rekuizitave, ndihmës regjisor, etj.). Mësuesi udhëzon mbi përgatitjen e një skene sipas hapave:

	- Çdo grup përgatit një skenë të shkurtër (1–2 minuta) nga materiali i dhënë. - Aktorët mësojnë dhe interpretojnë. - Regjisori jep udhëzime për vendosjen, mënyrën e të folurit, etj. - Kujdestari i kostumeve dhe rekuizitave organizon veshjen dhe skenografinë. - Ndhmësit koordinojnë hyrjen/daljen dhe mbajnë shënime për vështirësitë. Në fund të orës bëhet një reflektim nga vetë nxënësit. “Roli im ishte...”, “Detyra ime ishte...”, “Mësova që...” “E ndihmova grupin tim duke...”
--	--

Diagrama 3. Shembull situate të nxëni dhe lidhja me elementet e programit “Një objekt, një botë”

(Si ndryshon kuptimi i një skene kur përdorim kostume dhe rekuizita të ndryshme)



6 METODOLOGJIA E MËSIMDHËNIES

Mësimdhënia dhe të nxënit efektiv përfshin një kombinim qasjesh, strategjish, metodash dhe teknikash që përdoren për të mbështetur të nxënësit efektiv dhe zhvillimin e kompetencave të nxënësve në mjediset mësimore. Këto strategji dhe metoda kanë parasysh dhe plotësojnë nevojat e të nxënësit si dhe sigurojnë pjesëmarrjen aktive të nxënësve në përzgjedhjen dhe shfrytëzimin e informacionit, duke nxitur përgjegjësinë vetjake, iniciativën, reflektimin, pavarësinë e gjyqimit, vetevlerësimin, bashkëpunimin dhe barazinë. Edukimi promovon disa metoda të nxëni të cilat janë: a) Të nxënit me në qendër nxënësin; b) Të nxënit që promovojnë kompetencat; c). të nxënit e diferencuar; d) të nxënit e integruar; dh) Përdorimi i teknologjisë digjitale; e) Mësimin e kombinuar; ë) Të nxënit e bazuar në projekte; f) Angazhimi aktiv; g) Zhvillimin e të menduarit kritik dhe zgjedhjes së problemeve; gj) Të nxënit në bashkëpunim; h) Të nxënit e bazuar në krijime etj.

6.1 Qëllimi dhe roli i situatave të të nxënit praktike nga jeta reale në mësimin e teatrit.

Metoda mësimore në lëndën e teatrit kanë si qëllim: *të ndihmojë mësuesin të organizojë, drejtojë dhe vlerësojë procesin mësimor për teatrin, në mënyrë që nxënësit të zhvillojnë aftësi krijuese, komunikuese, bashkëpunuese dhe të mendimit kritik.*

Parime themelore të metodologjisë së teatrit në shkollë:

Parimi	Zbatimi në praktikë
Qasje e të nxënit aktiv	Nxënësit janë pjesëmarrës të drejtpërdrejtë në role dhe situata.
Mësimi përmes përjetimit	Mësojnë përmes ndjenjës dhe veprimit, jo vetëm përmes të folurit.
Qasje e të mësuarit bashkëpunues	Puna në grupe, ndarje rolesh dhe përgjegjësisë.
Zhvillimi i të menduarit kritik dhe reflektues	Nxënësit analizojnë veprat, diskutimet dhe përvojat skenike.
Ndërthurja me realitetin	Situata dramatike lidhen me përjetime dhe tema aktuale.

Metoda/Teknika	Përshkrim shkurtër	Shembull konkret
Improvizimi	Nxënësit krijojnë situata pa tekst të shkruar	“Një takim i papritur në autobus”
Lojërat dramatike	Lojëra për të zhvilluar imagjinatën, trupin, zërin	Lojë me emocione – “aktrimi i heshtur”
Leximi dramatik	Lexim me intonacion dhe interpretim emocional	Fragment nga “Toka Jonë”
Dramoskicë (Mini-skena)	Krijimi i pjesëve të shkurtra me mesazhe konkrete	“Një ditë pa celularë”
Dramatizimi i përrallave	Transformimi i tregimeve në skena	“Luani dhe miu”, “Ujku dhe qengji”
Krijimi i karakterit	Nxënësi ndërton një personazh nga fillimi	“Krijo një personazh me sekret”
Ndërtimi i skenës në grup	Grupet organizojnë vetë hyrjen, konfliktin, zgjidhjen	Mini-shfaqje me tema sociale

7 VLERËSIMI I NXËNËSVE

Në mësimin e teatrit, vlerësimi i nxënësve në arsimin fillor dhe arsimin e mesëm të ulët është pjesë shumë e rëndësishme e procesit mësimor dhe ndihmon mësuesin të kuptojë se sa mirë po i mësojnë nxënësit njohuritë dhe aftësitë që lidhen me kompetencat e kësaj lënde. Në lëndën e teatrit qëllimi i vlerësimit nuk është vetëm vendosja e një note, por të sigurohet një **vlerësim i vazhdueshëm**, gjatë procesit dhe në fund, që merr parasysh **angazhimin, përparimin, krijimtarinë dhe bashkëpunimin**, jo vetëm rezultatin përfundimtar.

Fusha e vlerësimit	Çfarë vlerësojmë konkretisht?
Angazhimi personal	Pjesëmarrja aktive, përpjekja, përkushtimi
Komunikimi dhe shprehja	Si përdor zërin, trupin, mimikën, ritmin, pauzat
Krijimtaria	Sa origjinale është ideja, si interpreton ndryshe
Bashkëpunimi	Si sillet në grup, si respekton rolet e të tjerëve
Reflektimi	A kupton çfarë funksionoi, çfarë mund të përmirësojë
Zbatimi i teknikave teatrore	Përdorimi i mjeteve: kostume, rekuizita, vendosja në hapësirë

7.1 Shembuj të niveleve të arritjes për vlerësimin e rezultateve të të nxënit, RN-ve.

Mësuesi ndërton një sërë instrumentesh për vlerësimin e nxënësit në teatër duke iu referuar specifikave të lëndës. ***Instrumentet e vlerësimit*** janë të domosdoshëm për të marrë informacion lidhur me zotërimin e njohurive dhe demonstrimin e aftësive skenike nëpërmjet treguesve të besueshëm për progresin e tyre. Vlerësimi i nxënësve në lëndën e **teatrit** duhet të jetë **i matshëm**, duke përfshirë tregues jo vetëm për njohuritë mbi

dramaturgjinë, por edhe shkathtësitë e inetrepretimit skenik, dhe analizimit të veprave skenike. *Tabela 5. Shembull 1 dhe 2 për nivelet e arritjes për vlerësimin e RN-ve*

Shembull 1:			
Rezultati i të nxënit (RN): Nxënësi zbaton rolet dhe detyrat e secilit në një projekt teatror.			
Niveli i arritjes: Shumë mirë	Niveli i arritjes: Mirë	Niveli i arritjes: Mjaftueshëm	Niveli i arritjes: Dobët
Nxënësi merr me përgjegjësi rolin e caktuar, e kupton funksionin e tij në trupë, bashkëpunon aktivisht me grupin, ndihmon të tjerët, dhe tregon përkushtim gjatë gjithë procesit. Iniciativë dhe krijimtari në zbatimin e detyrave.	Nxënësi kupton rolin e vet dhe detyrat përkatëse, angazhohet në grup, tregon përpjekje të qëndrueshme, por ka nevojë për nxitje ose ndihmë në momente të caktuara.	Nxënësi përfshihet pjesërisht në detyrat e grupit; ka vështirësi në kuptimin e rolit të vet, shpesh tërhiqet nga puna ose nuk tregon përkushtim të mjaftueshëm.	Nxënësi nuk merr përgjegjësi për rolin, nuk përfshihet aktivisht në detyra dhe ka nevojë të vazhdueshme për mbështetje dhe drejtim nga mësuesi apo grupi.

Shembull 2:			
Rezultati i të nxënit (RN): Nxënësi përdor gjuhën trupore dhe mimikën për të shprehur ndjenja dhe situata në teatër.			
Niveli i arritjes: Shumë mirë	Niveli i arritjes: Mirë	Niveli i arritjes: Mjaftueshëm	Niveli i arritjes: Dobët
Nxënësi shpreh me qartësi dhe larmi emocione dhe situata përmes gjuhës	Nxënësi përdor gjuhë trupore dhe mimikë për të përcjellë	Nxënësi përdor mimikën dhe trupin në mënyrë të kufizuar ose jo të qartë.	Nxënësi nuk arrin të përdorë mimikën ose trupin për të

trupore dhe mimikës. Lëvizjet janë të sinkronizuara me qëllimin skenik, dhe përdorimi i trupit rrit fuqinë shprehëse të interpretimit. Krijon ndikim te publiku.	emocione bazë dhe situata, me disa momente të qarta shprehjeje. Ka përpjekje të dukshme për të ndërlidhur lëvizjen me ndjesinë e skenës.	Disa emocione mund të duken, por jo gjithmonë në përputhje me situatën. Ka nevojë për udhëzim për të rritur ndërgjegjësimin trupor.	shprehur situatën ose emocionin. Lëvizjet janë të ngurta ose pa lidhje me interpretimin. Ka nevojë për mbështetje të drejtpërdrejtë dhe ushtrime bazë.
--	--	---	--

8 BURIMET DHE MATERIALET DIDAKTIKE

Gjatë procesit mësimor të teatrit, përdorimi i burimeve dhe materialeve të ndryshme ndihmon në ndërtimin e një kuptimi të thellë dhe praktik të njohurive teatrale.

8.1 Burimet Didaktike për Mësimin e Teatrit

a) Tekste dhe materiale letrare

- Dramat klasike dhe moderne: Përdorimi i teksteve të autorëve si Ëilliam Shakespeare, Anton Çehov, Bertolt Brecht, Ismail Kadare, etj.
- Dialogë të shkurtër për ushtrime improvizimi.
- Tekste të krijuara nga nxënësit – nxisni shkrimin kreativ dhe skenat spontane.

b) Manuale dhe udhëzues metodikë

- Manuale për mësimin e teatrit në shkolla (nëse ekzistojnë sipas kurrikulës kombëtare).
- Udhëzues për lojëra teatrale, zhvillim personazhi, teknika improvizimi.
- Fletë pune për zhvillimin e kompetencave krijuese dhe reflektuese.

c) Rekuizita dhe mjete skenike

- Rekuizita të thjeshta: maska, kostume, objekte të përditshme.
- Materiale për ndërtimin e skenografisë nga letër, karton, ngjyra etj.

- Hapësira e përshtatshme në klasë për të krijuar “skena” të vogla.

d) Videomateriale dhe regjistrime

- Shfaqje teatrale të regjistruara (nga Youtube, arkiva të teatrove kombëtare).
- Dokumentarë mbi procesin e krijimit të një shfaqjeje teatrale.
- Filma artistikë me bazë dramatike për analizë karakteresh dhe veprimi.

8.2 Përdorimi i Teknologjisë në Mësimin e Teatrit

a) Prezantime dhe mjete digjitale

- PoëerPoint / Canva / Google Slides për paraqitje vizuale të temave (historia e teatrit, elementet skenike, teknikat e interpretimit).
- Padlet, Jamboard ose Miro për bashkëpunim në hartimin e skenarëve dhe analizave.

b) Platforma video për analizë dhe reflektim

- Përdorimi i YouTube për të parë shfaqje të ndryshme teatrale, krahasuar stilet dhe interpretimet.
- Nxënësit mund të xhirojnë interpretimet e tyre dhe të bëjnë vetëvlerësim ose feedback në grup.

c) Audio dhe efekte zanore

- Përdorimi i aplikacioneve si Soundtrap, Audacity për të regjistruar narracione, efekte zanore ose muzikë për skenat.
- Nxënësit mësojnë si të krijojnë atmosferë nëpërmjet zërit.

d) Platforma të mësimit në distancë

- Google Classroom, Moodle ose Edmodo për shpërndarjen e materialeve, ngarkimin e detyrave dhe feedback.
- Mund të përdoren për të organizuar reflektime, ese, ose diskutime mbi shfaqje të ndjekura online.

e) Aplikacione për krijim skenarësh

- Celtx apo ËriterDuet për të ndihmuar nxënësit të shkruajnë skenarë në mënyrë të strukturuar.
- Përdorimi i këtyre platformave nxit aftësi teknike dhe punë bashkëpunuese.

9 REKOMANDIME PËR ZBATIMIN E PROGRAMIT

Hartimi i programit të lëndës së teatrit bazohet në Kornizën Kurrikulare e Arsimit Parauniversitar, Kurrikulën Bërthamë, Plani Mësimor i Arsimit Bazë si dhe në rekomandimet më të fundit të Bashkimit Europian për arsimin. Si i tillë ky dokument i shërben mësuesve, vlerësuesve të jashtëm të cilësisë, prindërve, nxënësve. Në këtë rubrikë përshkruhen disa rekomandime për zbatuesit e programit në mënyrë që të zhvillohet me efektivitet programi i lëndës së teatrit.

a) Rekomandime për mësuesit

- ✓ Të lidhin përmbajtjen e teatrit me fusha të tjera (gjeografi, gjuhë, histori, art pamor, edukatë qytetare, TIK, etj.) për të ndihmuar kuptimin e thelluar dhe zbatimin praktik të koncepteve dhe për të kuptuar profesione të ndryshme.
- ✓ Të krijojnë aktivitete praktike që e ndihmojnë nxënësin të kuptojë përdorimin e teatrit në jetën e përditshme dhe lidhjen e saj me profesione të ndryshme.
- ✓ Të planifikojnë mësimin duke respektuar ritmet dhe nevojat individuale të nxënësve me nevoja të veçanta dhe për fëmijët me aftësi me talente.
- ✓ Të nxisin mjedisin bashkëpunues, të sigurt, ku nxënësit ndihen të vlerësuar dhe të mbështetur në zhvillimin socio - emocional.
- ✓ Të sigurojnë akses të barabartë në mësim për të gjithë nxënësit, përfshirë ata nga pakicat kombëtare dhe grupe të marginalizuara.
- ✓ *Të sigurojnë balancën mes përmbajtjes teorike dhe përdorimit praktik të teatrit (p.sh. sugjerohet 40% teori — 60% praktikë). Përdorimi praktik i teatrit do të realizohet përgjatë çdo ore mësimore. Mësuesi është fleksibël që në varësi të kontekstit të ndryshojë këto përqindje.*
- ✓ Të sigurojnë dhe të përdorin udhëzuesit kurrikularë të lëndës së teatrit.
- ✓ Të përdorin materialet burimore për zbatimin e programit.

b) Rekomandime për vlerësuesit e jashtëm

- ✓ Të vlerësojnë mësuesit për cilësinë e mësimdhënies në zbatim të programit dhe rubrikave të këtij programi.
- ✓ Të vlerësojnë mësuesit për përdorimin e situatave nga jeta reale në përvetësimin e koncepteve dramaturgjike.
- ✓ Të vlerësojnë përdorimin e niveleve të arritjes për përmbushjen e rezultateve të të nxënit.
- ✓ Të vlerësojnë organizimin e punës në grupe dhe bashkëpunimin në veprimtaritë mësimore.
- ✓ Të vlerësojnë balancën mes përmbajtjes teorike dhe përdorimit praktik të teatrit gjatë zhvillimit të orëve mësimore.
- ✓ Të nxisin mësuesit që të krijojnë mjedise të përshtatshme për personalizimin e të nxënit dhe për mbështetjen e diversitetit në klasë.
- ✓ Të vlerësojnë se si mësuesit promovojnë mirëqenien socio - emocionale të nxënësve përmes mënyrës së komunikimit dhe aktiviteteve në orën e teatrit.
- ✓ Të vlerësojnë që mësuesit garantojnë qasje të barabartë në mësim për të gjithë nxënësit, përfshirë pakicat kombëtare dhe grupet vulnerabël.

c) Rekomandime për prindërit

- ✓ Të inkurajojnë fëmijët që të kuptojnë rëndësinë e teatrit jo vetëm për notë, por për jetën e përditshme.
- ✓ Të sigurojnë që fëmijët ndihen të mbështetur emocionalisht dhe që mësimi i teatrit zhvillohet në një atmosferë të qetë dhe motivuese për fëmijët e tyre.

d) Rekomandime për nxënësit

- ✓ Të marrin pjesë aktive në orët e teatrit, duke kërkuar të kuptojnë përdorimin praktik të njohurive dramaturgjike.
- ✓ Të bashkëpunojnë me shokët si në klasë ashtu edhe jashtë saj.
- ✓ Të jenë kureshtarë dhe të kërkojnë ndihmë kur hasin vështirësi, duke përfshirë edhe përdorimin e mjeteve digjitale dhe burimeve online.
- ✓ Të kuptojnë rëndësinë e teatrit si bazë për profesione të ndryshme dhe të eksplorojnë interesat personale në këtë drejtim.